Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Sigurim oferte, (**nuk është e zbatueshme**) sipas Shtojcës 3;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
- g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12).

### 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Kopje të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimor (**2017-2018-2019**), të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara prej tyre. Gjithashtu bilancet duhet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

#### DHE

**2.2.2** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku mesatarja të jetë në një vlerë sa 50 % e fondit limit që prokurohet përkatësisht: **105,429,411 (Njëqindpesëmilionekatërqindnjëzetëe nëntëmijëekatërqindnjëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.** (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

#### DHE

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin **2019** dhe për vitin e fundit **2020 (këstet e maturuara)**, duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku operatorët ekonomike ushtron/jnë aktivitetin. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

## 2.3 Per kapacitetin teknik:

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

**2.3.1** Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

**a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **105,429,411 (Njëqindpesëmilion ekatërqindnjëzetëenëntëmijëekatërqindnjëmbëdhjetë) lekë pa tvsh**, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

ose

**b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 421,717,644 (Katërqindnjëzetëenjëmilioneshtatëqindeshtatëmbëdhjetëmijëegjashtë qindedyzetëekatër) lekë pa tvsh**. *Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmëndura e ben oferten të kualifikueshme.**

**1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatori/et ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas **shtojcës Nr. 9**, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes,
  3. Situacionin përfundimtar të objektit ,
  4. Aktin e kolaudimit të objektit ,
  5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit .
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes,
  3. Situacionin përfundimtar të objektit ,
  4. Akt kolaudim të objektit,
  5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;
  6. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar,

**Pika 2.3.1 gërma a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1 gërma b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.



**2.3.2** Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in liçenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve objekt të prokurimit të kategorive dhe niveleve:

**PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

1. NP- 1 B Punime gërmimi në tokë.
2. NP- 2 A Ndërtime civile dhe industriale.
3. NP- 4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
4. NP- 5 B Punime nentokesore, ura e vepra arti
5. NP- 7 D Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
6. NP-12 B Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

**PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

1. NS- 4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to.....
2. NS- 9 A Punime strukturore special
3. NS- 16 D Ndërtim impianteve te ujit të pijshëm
4. NS- 18 C Punime topogjeodezike

• **sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;**

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**2.3.3 Stafi kryesor e mbështetes, punonjësit, liçensimet.**

**a.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimumi inxhinierët e mëposhtëm:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier gjeodet ose topograf
- 1 (një) inxhinier hidroteknik;
- 1 (një) inxhinier mekanik;
- 1 (një) inxhinier elektrik;
- 1 (një) inxhinier mjedisi
- 1 (një) inxhinier gjeolog

Inxhinieret e sipercituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.

**Për secilin duhet të paraqiten:** Kontratë pune noteriale e vlefshme, Diploma

**Për inxhinierin e mjedisit** të paraqitet çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. *(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

**b.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve **i diplomuar në inxhinieri ndërtimi** i cili duhet të jetë i pranishëm në objekt për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera . Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës **personale nga vetë drejtuesi teknik** i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues.

- c. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin mbështetës të shoqërisë minimumi **1 (një) punonjës** i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Për të cilin të paraqiten:**

- Kontratë pune noteriale e vlefshme
- Diplomë ose çertifikatë
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

- d. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin mbështetës të shoqërisë minimumi **1 (një) punonjës** i cili të disponojë çertifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

**Për të cilin të paraqiten:**

- Kontratë pune noteriale e vlefshme
- Diplomë ose çertifikatë
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

- e. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin mbështetës të shoqërisë minimumi **1 (një) specialistë** të pajisur me çertifikatë trajnimi për ngjitjen/montimin e tubave HDPE e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune noteriale e vlefshme
- Diplomë ose çertifikatë
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

- f. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011 ”Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar),

**Për të cilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë
- Urdhër Mjeku

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje, në mbështetje të legjislacionit të sipercituar). Njëkohësisht në përputhje me Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.*

- g.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar si staf teknik **39 (tridhjetëe nëntë )** punonjës të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë nga të cilët të jenë:

NR	EMERTIMI	
1	Teknik Ndertimi	(3 persona)
2	Elektracist	(3 persona)
3	Hidraulik	(4 persona)
4	Mekanik	(4 persona)
5	Saldator	(4 persona)
6	Hekurthyes	(4 persona)
7	Karpentier	(4 persona)
8	Murator	(4 persona)
9	Automakiniste	(2 persona)
10	Shofer	(4 persona)
11	Manovratorë mjetesh të renda	(3 persona)

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.
- Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë.
- Për teknikët e ndërtimit të paraqitet edhe dëshmia/diploma lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore që provon se janë teknikë ndërtimi.
- Për manovratorët të paraqitet edhe dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë e lëshuar nga DPSHTRR dhe në rastin kur makineritë dhe pajisjet disponohen me qera, **Shofer (4 persona) , Manovratorë mjetesh të renda (3 persona)**, mund të disponohen nga operatori/et ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit, **për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listëpagesat e shoqërisë.**

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

**h.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të paraqesin dëshmi nga administrata tatimore ku të ketë një punësim mesatar i të paktën **145 (njëqindedyzetëepesë)** punonjës për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qërshor 2020 - Nëntor 2020**.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

**2.3.4 Operatori/et ekonomik** duhet të jetë/jenë të pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

**a.** Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- OHSAS 18001-2007 ose **ISO 45001-2018** (ose ekuivalente)
- ISO 14001-2015 (ose ekuivalente)
- PAS 99-2012 (ose ekuivalente)
- ISO 50001 -2011 (ose ekuivalente)
- EN ISO 3834-2:2006 (ose ekuivalente)

*Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto çertifikata. (ose ekuivalente), në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje ).*

Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi konformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**VO:** Nëse çertifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

**b.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve dhe dherave jo të rrezikshme urbane”. *(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*

- c. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.A. Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis. *(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).*
- d. Operatori/et ekonomik ofertues për materialet:

**Tuba e rakorderi ujesjellësi HDPE.**

për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. **Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .**

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet ose certifikatat e testimit **nga prodhuesi ose distributori** nga laboratorë të certifikuar sipas metodës EN 10204 ose **ekuivalente** nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare të akreditimit.

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë gjithashtu certifikata testimi **nga prodhuesi ose distributori** për tubat e lart permendur që vërteton se tubat të parashikura në preventiv janë për përdorim për ujë të pijshëm, nga laboratorë të certifikuar sipas ISO/IEC 17025 ose **ekuivalente** nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje, në mbështetje të legjislacionit të sipercituar.*

**2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qera	Copë 4
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min10-max 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 5 –max 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në max 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
5	Mjete germimi me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Autovinc	në pronësi ose me qira	Cope 2
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
9	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2

Dokumenta Standarde të Tenderit

10	Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Cope 2
12	Freze asfalti	në pronësi ose me qira	Cope 1
13	Saldatrice / motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 2
14	Moto pompe thithese	në pronësi ose me qira	Cope 1
15	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Cope 2
16	Bobcat	në pronësi ose me qira	Cope 2
17	Grejder	në pronësi ose me qira	Cope 1
18	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Cope 1
19	Rul ngjeshes	në pronësi ose me qira	Cope 1
20	Rul me kompresor	në pronësi ose me qira	Cope 1
21	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
22	Fabrikë betoni jo më shumë se 60 km distancë nga sheshi i ndërtimit.	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Cope 1
23	Impiante për thyerje dhe seleksionim materiale inertesh jo me larg se 60 km nga objekti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Në pronësi ose me qera <b>ose kontrate furnizimi</b>	Cope 1
24	Çekic pneumatik per thyerjen e betoneve	Në pronësi ose me qera	Cope 1
25	Kompresor ajri	Në pronësi ose me qera	Cope 1
26	Total station per matje topografike	Në pronësi ose me qera	Cope 1
27	GPS per matje topografike	Në pronësi ose me qera	Cope 1

Nr	Paisje specifike per realizimin e ujesjellesit	Statusi	Sasia
1	Paisje saldimi per tuba HDPE koke me koke	në pronësi ose me qira	Cope 2
2	Paisje saldime per tuba HDPE elektrofuzive	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Detektor rrjetesh nentokesore paisur me monitor LCD, Wireless, GPS, Bluetooth per theleshi mbi 7m	në pronësi ose me qira	Copë 1

**Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:**

- Kokore minimumi **145 copë**
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 copë

Eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojces nr.10 dhe dokumentacioni si me poshte:

- a) Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), foto te mjetit .
- b) Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit,(te vlefshme), foto te mjetit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese noteriale te qerases/furnizimit e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij, foto të pajisjes.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) ***Për fabrikën e prodhimit të betonit***  
*a) në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, bashkë me Aktin e Miratimit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .*  
*ose*  
*b) në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për fabriken e prodhimit të betonit.*  
*ose*  
*c) në rast të kontratës së furnizimit të paraqitet kontrata e furnizimit me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për fabriken e prodhimit të betonit.*  
*Ajo duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit ,për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e betonit. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përbën kusht për skualifikim.*
- f) ***Për Impiantin e thyerjes dhe seleksionimit materiale inertesh***  
*a) në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, bashkë me Aktin e Miratimit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .*  
*ose*  
*b) në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për Impiantin e thyerjes dhe seleksionimit materiale inertesh.*  
*ose*  
*c) në rast të kontratës së furnizimit të paraqitet kontrata e furnizimit me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për Impiantin e thyerjes dhe seleksionimit materiale inertesh .*  
*Impianti i thyerjes dhe seleksionimit të materialeve inerte duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përbën kusht për skualifikim.*
- g) *Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura në piken 2.3.6 të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratë të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

**2.3.6** Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit **për 12 ( Dymbëdhjetë ) muaj kalendarik.**

**2.3.7** Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që është dakort me mënyrën e financimit sipas fondeve të miratuara me shkresë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjensia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve nr. nr.3002 prot. datë.24.11.2020, “Dërgohet miratimi i objektit për programin , “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”.

**2.3.8** Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimi.

**2.3.9** Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërise ofertuese ku të deklarojë se i gjithë dokumentacioni i paraqitur në tender është i saktë dhe nuk përmban të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

**2.3.10** Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Në lidhjen me markat specifike të përcaktara në preventiv emertimet e markave shoqerohen me fjalën **ose ekuivalent** .



### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: **Bashkangjitur Dokumentave Standarte të Tenderit.**

Specifikimet Teknike të Materialeve: **Bashkangjitur Dokumentave Standarte të Tenderit.**

Grafiku i Punimeve: Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit **për 12 ( Dymbëdhjetë ) muaj kalendarik.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Bashkangjitur Dokumentave Standarte të Tenderit.**

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**Bashkangjitur Dokumentave Standarte të Tenderit.**

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_

numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkëlqje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

